

PASHK PËRVATHI
RRUGËTIMI IM

BOTIMET TOENA

PASHK PËRVATHI

RRUGËTIMI IM

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj
Kopertina: Rezarto Kulli
Fotot: Alqi Gollosi

ISBN 9789928376787

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

DY FJALË

Dita për të shkruar kujtimet e mia më dukej gjithnjë e largët. Heraherës kam qenë dyshues nëse do të ndodhte ndonjëherë. Ndoshta sepse këtë punë e imagjinoja si profesion të shkrimtarëve. Ndoshta sepse mendoja që në Shqipëri ende nuk është bërë traditë që krijuesit figurativë të shkruajnë për veten e tyre.

Gjatë viteve të studimeve në Akademinë e Arteve, fillova të mbaj shënime për ngjarje që përbënin rëndësi në jetën time, duke krijuar edhe një skedar të shkurtër për ngjarjet kryesore të kohës së kaluar.

Në vitin 2011 kam qenë i ftuar në dy-tri televizione të rëndësishme të vendit për të folur për krijimtarinë time në tërësi. Në këto biseda të gjata televizive e kam prekur edhe zanafillën e lindjes tek unë të pasionit për pikturën. Shumë miq të mi, kur u njohën me jetën time krijuese nëpërmjet këtyre emisioneve televizive, më shtynë më tej që këto kujtime t'i hidhja në letër.

Por, thellë-thellë, e ndieja se një ditë do të ulesha dhe do ta prishja tabunë: do ta shkruaja vetë jetën time, me mbresat e kujtimet, ashtu siç i kam provuar vetë... Fundja, më mirë se unë nuk e njeh askush tjetër jetën time! Ajo është e pasur, por edhe e brishtë. Është jeta e një fëmije fshati që ka provuar gjithçka, vuajtje e hidhërimi të shumta, por edhe gëzime, gjithashtu. Në rrugën për t'u ngjitur jam rrëzuar disa herë, por nuk jam dorëzuar. Kjo ngjitje ka qenë e mundimshme, por drita, më në fund, është parë...

Në këtë rrëfim të jetës sime, të hedhur në këtë libër, mos prisni penën e shkrimtarit. Unë nuk di të shkruaj si ata. Madje, as pretendimin nuk e kam të tillë, sepse për mua kjo është e pamundur. Por një gjë di t'ju

them me siguri, jeta ime në këtë libër është ashtu siç ajo ka rrjedhur në të vërtetë, e pasajuar dhe pa truke. Të vërtetat e jetës sime krijuese dua t'i ndaj me Ju, miqtë e mi, me Ju artdashësit që e keni mbështetur veprën time dhe më keni dhënë forcë për të kërkuar më shumë. Ndoshta edhe të afërmit dhe vetë fëmijët e mi nesër do të më njohin pak më tepër. Prandaj desha të shkruaj dhe shkrova.

*Rrëfimi im është për të gjithë Ju.
Autori*

MBRESA FËMIJËRIE

Shpeshherë përpiqem të kujtoj se cilat janë ngjarjet e para të fëmijërisë sime, cilat janë ato dhe cilës moshë i përkasin. Ka kaluar kohë e gjatë e shumë kujtime janë fshirë nga kujtesa. Fëmijëria tashmë ka mbetur si një mjegull e largët, por që, për ngjarje të caktuara, shpeshherë më vijnë përjetime imagjinare të skenave që kanë ndodhur, ose ndoshta nuk kanë ndodhur kurrë, por mua më duken të tilla. Janë përfytyrime që kanë mbetur edhe nga lloji i ngjarjes që ka pasur lidhje me një kohë të caktuar. Ndoshta pse kanë qenë të tilla disa prej tyre janë ngulitur thellë në kujtesën time.

Nuk i kisha mbushur ende 5 vjeç në shtatorin e vitit 1962, kur në familjen tonë do të bëhej dasmë. Martohej Ndueja, djali i madh i xhaxhait tim, Palit. Nuk mbaj mend shumë skena në atë dasmë, por një gjë e kujtoj shumë mirë. Kur mbërritën krushqit me nusen, të gjithë ne fëmijët, siç ishim, u turrëm për t'i pritur. Unë isha bashkë me Gjergjin, djalin e vetëm të xhaxhait tim, Zefit, 10 vite më i madh se unë. Në krye të krushqve ishte një burrë me mustaqe të mëdha, i veshur me kostumin tradicional mirditor. Kali i nuses ndaloi nën hijen e manave në qendër të oborrit. Burri me mustaqe të mëdha mori një fëmijë të moshës sime, të parazgjedhur për këtë rast, dhe bashkë me një tjetër burrë, e rrotulloi 360 gradë nga poshtë-sipër kalit. Mua më dukej e frikshme kjo skenë, por Gjergji më mbante afër e kjo më jepte forcën për ta ndjekur ritualin. Fëmijës që kapërceu kalin i dhanë një dhuratë dhe ai i kënaqur humbi në morinë e dasmorëve. Më vonë djalin që kapërceu kalin e pata shok klase. Quhej Mikel Fran Dushi dhe ishte me origjinë nga Shkodra.

Po nga kjo periudhë kujtoj edhe një ngjarje të rëndë. E ndoshta pse ishte e tillë e mbaj mend kaq mirë. Ishin ditët e para të fillim vitit 1963. Djali i xhaxhait, Gjergji, erdhi në shtëpi dhe na dha lajmin se lumi Drin kishte dalë nga shtrati. Tha, gjithashtu, se rrjedha kishte rrëmbyer tre njerëz nga Ishull-Lezha dhe me siguri kishin përfunduar në det. Me shumë gjasa uji do të vinte edhe në drejtim të Manatisë. “Edhe ne mund të përmytemi!”, tha me një lloj frike që dukej qartë në fytyrën e tij. Mbaj mend, gjithashtu, fytyrat e trishtuara të prindërve, nënës së Gjergjit dhe gjyshes sime, që na porositen ne fëmijëve të mos dilnim jashtë, por të rrinim në katin e dytë të shtëpisë. Atëherë jetonim të gjithë në një shtëpi. Gjatë atyre ditëve, por edhe më vonë, gjithnjë përfytyroja ata tre njerëz të rrëmbyer nga rrjedha e ujit në përpjekjen e tyre për të shpëtuar. Vite më vonë, kur u rrita, mësova se vërtet në atë vit nga dalja e shtratit e lumit Drin kish ndodhur një përmytje e madhe. Bile edhe sot ruhet në memorien e gjithkujt si ndër përmytjet rekord të ndodhura ndonjëherë në Lezhë. Janë trashëguar edhe foto të asaj periudhe, ku njerëz me varka notonin në qendrën administrative të qytetit. Në një pllakë përkujtimore të vendosur në anën perëndimore të ndërtesës së vjetër të Komitetit, shënohet me një vizë të thelluar në beton niveli i daljes së Drinit në vitin 1963.

Kur isha i vogël, isha shumë i lidhur me Gjergjin. Jetonim së bashku në një shtëpi. Ai kishte vetëm nënën, sepse babai e kishte lënë jetim që në moshën dyvjeçare nga një aksident me makinë. I kisha mbushur pesë vjeç dhe Gjergji më merrte me vete kudo që shkonte e në darkë flinim bashkë te dhoma jonë, në katin e parë të shtëpisë.

Unë isha fëmija i dytë i familjes. Kur erdha në jetë, si mësova më vonë, babai kishte organizuar një festë të madhe. Dita, edhe pse kish qenë e ftohtë e me borë, nuk i kishte penguar tridhjetë burra të hanin, të pinin, të këndonin e të gjuanin me pushkë në dritare, për lindjen e djalit të parë të Gjok Përvathit. Në pleqërinë e tij, babai shpesh ma ka rrëfyer këtë skenë të asaj dite me borë. Të gjithë kemi nostalgji për të shkuarën e pikërisht kjo ditë ndoshta ishte ndër më të bukurat e jetës së babait tim, që e bënte të ndihej mirë edhe tani!

Nëna asokohe punonte në fermën e Treshit, ndërsa babai në kooperativën e sapokrijuar në Manati. Deri rreth viteve '90 trashëgova nga ajo periudhë një karrige, të cilën e kishte punuar një marangoz posaçërisht për mua kur isha 4 vjeç. Ishte një karrige e vogël, që mund të përdorej nga fëmijë të moshës deri në dhjetë vjeç. Për aq kohë sa "jetoj" në shtëpinë tonë, ne i thoshim gjithnjë "karrigia e vogël". Kishte formën e karrigeve të zakonshme dhe e lyer me ngjyrë qielli të hapur. Në mbështetësen e saj ishte një dekoracion në formë krehri. Më vjen keq që nuk e kam më... Ajo do të ishte një relikte e fëmijërisë sime.

Përvathët patën zbritur nga Oroshi i Mirditës në Manati rreth viteve 1800. Në njëqindvjeçarin e parë fisi vetëm sa pati mbijetuar, thuhet se sëmundja e kolerës kish bërë kërdrinë, aq sa në fillim të shekullit XIX, i vetmi mashkull i Përvathëve ishte Nikolla. Me pesë bijtë e tij - Lleshin, Gjonin, Nduen, Dedën dhe Frrokun - fisi mundi të shtohet, dhe sot numërohen rreth 40 shtëpi të shpërndara në Manati e Lezhë, Tiranë, por edhe më larg. Në këtë njëqindvjeçar, meshkujt patën qenë dhe vazhdojnë të jenë në numër më shumë se vajzat e fisit.

Gjyshi nga babai ish ndarë nga jeta në moshë të re nga pickimi i një akrepi. Edhe babai im ruan shumë pak kujtime nga i ati. Bile kujtimi i tij i vetëm është rasti kur i ati iu nda nga jeta. Ai nuk ishte mërzhitur, por kish menduar se tashmë do të ishte i lirë të rrëshqiste në një rrëpirë prej dheu dhe balte përbri shtëpisë së tyre. Pak ditë para se të largohej përgjithmonë nga kjo jetë, gjyshi im ia kishte ndaluar dhe e kishte rrahur për këtë lojë që bënte. Ajo ishte jo vetëm e rrezikshme, por edhe rrobat ndoteshin me baltë. Pikërisht për këtë ai nuk ishte mërzhitur kur i thanë se babai kishte vdekur. Nuk e kuptonte se çfarë ishte vdekja. Ishte ende i vogël për ta kuptuar se ajo çka kish ndodhur nuk kishte qenë lojë, po kishte humbur njëherë e përgjithmonë babanë. Këtë histori babai ma tregonte shpesh, por më vonë ua tregonte edhe fëmijëve të mi. Mendoj se e vuante që kishte kaluar një fëmijëri pa baba, pa përkëdheljet e pa këshillat e tij.

Gjyshja jonë ishte e dashur dhe shumë e lidhur me ne fëmijët. Ishte e fortë dhe ia kishte dalë mbanë të rriste e vetme 7 fëmijët e saj. Shpesh ajo ishte mburoja jonë sa herë bënim prapësitë e radhës. Bashkë me

gjyshen time Mara, kur isha në klasën e tretë fillore, bëra një rrugë të gjatë për te halla ime, Dila, e cila ishte e martuar në Rrasfik të Mirditës. Gjyshes i ishte mbushur mendja t'i bënte një vizitë të bijës. E kishte parë keq në ëndërr dhe nuk e mbante vendi pa shkuar tek ajo. Sapo u ktheva nga shkolla, më tha të bëhesha gati për në Rrasfik. Rruga do të bëhej më këmbë. Udhëtimi i asaj pasditeje do të ishte i gjatë, rreth 20 km. Mjete transporti asokohe nuk kishte. Ndonjë makinë në të rrallë kalonte gjatë gjithë ditës. Gjyshja 82-vjeçare, me mua 8 për 9 vjeç, udhëtoi për disa orë atë pasdite të bukur maji. Por kjo vizitë do të ishte e fundit për gjyshen time te vajza e saj. Ra në shtrat e sëmurë për të mos u ngritur më. Në shkurtin e ardhshëm gjyshja ndërroi jetë. Atë ditë vetëm unë u ndodha në shtëpi me të. Kur e ndjeu se nuk ishte mirë, më thirri e më tha të lajmëroja nënën time, Metrën, që të vinte në shtëpi. E bëra rrugën me vrap deri te puna e nënës. Ashtu i trembur për gjyshen e sëmurë, bashkë me nënën u kthyem shpejt në shtëpi. Lajmërova menjëherë dhe babanë, i cili punonte jo larg shtëpisë. Ai e gjeti nënën e tij në momentet e fundit të jetës. E ruaj edhe sot në kujtesë atë moment kur ajo dha shpirt. Pashë lotët që rrodhën në faqet e babait, edhe pse u mundua ta mbante veten. Gjyshja kishte qenë grua e fortë. Këtë e kam dëgjuar shpesh nga bashkëfshatarët e mi të rritur, që tregonin për mundimet që kishte hequr për të rritur fëmijët e mbetur jetimë nga vdekja e burrit në moshë të re.

Marrëdhënia ime me gjyshen ka qenë e veçantë, e doja shumë. Babai shpesh më ngacmonte kur isha i vogël dhe i pëlqente të më shihte kur kacafytesha me të. Unë isha "lodra" e tyre. Por kisha edhe prapësitë e mia prej fëmije me gjyshen time. Kur isha rreth moshës 5-6 vjeç, shpesh e ngacmoja me një revolver lodër. Ajo trembej e i thërriste tim ati: "Ma hiq qafe këtë fëmijë, se po më vret!". Nuk shikonte mirë dhe e mendonte lodrën si revolver të vërtetë. Njëherë, kur isha në klasë të parë, më dënoi që të mos dilja të luaja me shokët. Edhe topin e llastikut që ma kishte sjellë babai nga Shkodra, ma kishte fshehur. Shokët rrinin në fundin e oborrit duke më pritur, por gjyshja ime nuk dorëzohej. Sot, nuk e mbaj mend pse ma pati bërë atë dënim. Ka kaluar një jetë e tërë nga ndarja e saj prej nesh, por mua më vjen para syve fytyra e saj e bardhë, e butë e me shumë rrudha. Sytë i kishte të futur thellë në kockë e në faqe i dukeshin dy mollëzat, të cilat e hijeshonin edhe më shumë. Ishte shumë besimtare dhe merrte pjesë në të gjitha ritet fetare që kryheshin për festën e Krishtlindjes apo të Pashkës, udhëtonte nga Manatia për

të shkuar në kishën e Dom Lleshit të Lezhës. Në arkën e saj të rrobave mbante gjithnjë një pamje të stampuar në letër të Shën Mërisë. Ndoshta prej këtyre shënimeve që po shkruaj apo nuk e di pse, por mbrëmë m'u shfaq në ëndërr sikur ishte kthyer nga një udhëtim i gjatë. Ishte tamam si atëherë kur e mbaja mend unë, madje edhe më e bukur.

Babai ishte fëmija më i vogël i Ndue Përvathit. Kishte katër motra dhe dy vëllezër. Vendi ku lindi qe në Manati-Mal, për të zbritur më vonë në Fildanë. Por vite më pas, me zbritjen e të gjithë banorëve të Manatisë në Fildanë, edhe vetë Fildana u quajt Manati. Por mua më pëlqen që Manatisë t'i thuhet Fildanë. Ky emër më tingëllon më i bukur dhe më i ndjeshëm.

Babai, si më tregojnë, kish qenë fëmijë shumë i shkathët e ashtu mendoj se mbeti gjatë gjithë jetës së tij. Një burrë energjik, i palodhur, i gatshëm të hidhej në zjarr për të kryer një porosi të dhënë. Në moshën 16-vjeçare e mobilizuan ushtar. Shkoi në vend të vëllait të tij, Zefit, duke ia rritur moshën, sepse ai martohej. Pas ushtrisë dhe derisa doli në pension kreu detyra të ndryshme në Manati. Gjatë gjithë jetës së tij tregoi karakterin e një burri energjik, por paksa i rrëmbyer deri në vetësakrifikim. I pati munguar shkollimi, por me vetitë natyrale të lindura që zotëronte, mund të kishte qenë një burrë që do t'i kishte shërbyer edhe më shumë shoqërisë. Ashtu, edhe pse kishte vetëm arsimin 8-vjeçar, gjithnjë shërbeu në detyra të rëndësishme në Manati, duke qenë një ndër njerëzit më të spikatur të viteve '50-'90. Kur ishim fëmijë, ai u kujdes më shumë për pronën e përbashkët sesa për ne, fëmijët e tij. Ashtu qe kultivuar ai brez njerëzish të indoktrinuar nga ideologjia komuniste e kohës: prona e përbashkët mbi gjithçka. Por unë gjithnjë e kam kuptuar babanë tim në nismat e tij.

Nëna ime pati lindur në Kryezez të Mirditës, në vitin 1933. Familja e saj qe e madhe dhe me emër në atë zonë. Edhe unë kam qenë disa herë në Kryezez, te shtëpia ku kishte lindur nëna ime. Atje banonte vetëm xhaxhai i saj, Nikolla. Kulla e vjetër e dajave ishte trekatëshe dhe e fortifikuar me frëngji në të katër anët e saj. Dera e jashtme dhe qoshet ishin të skalitura me mjeshtri, me gurë në një ngjyrë gri në jeshile, që më shumë shkonte nga ngjyra okër e artë. Asgjë e kësaj kulle nuk ngjasonte me shtëpinë time në Manati, e cila ishte një kullë dykatëshe, por e varfër në elemente të tilla krahasuese. Vendndodhja e saj në majën e malit e bënte edhe më monumentale. Gjithçka tjetër përreth ishte e vrojtuar nga

ai vend. Nevoja e mbijetesës i kishte detyruar dajat e mi ta ndërtonin shtëpinë-kështjellë të tyre pikërisht në atë vend. Ata trashëgonin hasmëri me familjet e tjera. Por ndërkohë që kishin ndërtuar një shtëpi për vetëmbrojtje, ata kishin sjellë deri në kohët e vona të fëmijërisë dhe rinisë sime një monument kulturor, paçka se asnjëherë nuk u shpall i tillë nga pushteti i asaj kohe.

Nëna kish mbetur jetime që në moshë të vogël. Të atin ia kishin vrarë për hasmëri. Gjyshja Marë nga nëna, me tre fëmijët e saj dhe një xhaxha i nënës, edhe ai me familjen e tij, rreth viteve 1940 u shpërngulën nga Kryezez dhe u vendosën në Barbullojë të Lezhës. Barbulloja ishte pothuajse e gjitha kënetë dhe jo shumë larg nga deti. Dy kasollet e tyre, të ndërtuara me thupra mrinbardha dhe të lyera me baltë, ishin të vendosura rreth 50 m larg rrugës së vjetër me kalldrëm, e cila të çonte në Bregun e Matës. Si rrjedh jeta! Kishin ikur për mbijetesë nga një kullë e lartë trekatëshe e fortifikuar me frëngji si kështjellë e tashmë duhet të pajtoheshin me realitetin në një kasolle buzë moçalishteve! Edhe unë e kam njohur atë mënyrë jetese të dajave të mi. Ata ishin të dashur me ne. Nëna, bashkë me motrën, na merrte shpesh në vizitat që bënte tek e ëma dhe vëllezërit e saj, Lleshi dhe Gjini. Unë isha i përkëdheluri i tyre. Kishte raste që vinin në Manati dhe më merrnin me kalë për të shkuar në Barbullojë. Një rrugë të tillë me kalë kam bërë kur u martua daja im i madh. Ishte viti 1963 dhe nuk isha më shumë se 5 vjeç. Atë rrugë nuk kam për ta harruar qoftë për nga bukuria që e karakterizonte, por edhe nga frika që ndieja. Ishte koha e bonifikimeve të fushave të Lezhës e ne duhej ta bënim udhëtimin në mes këtyre moçalishteve. Kaluam mes ujërave të pafundme të kënetës. Mbjaj mend se kishte pemë të mëdha të rrëzuara nga buldozerët, rrënjë të dala në sipërfaqe të ujit, shpend e rosa gjithandej. Të dukej sikur më shumë kishte ujë dhe kënetë, sesa tokë.

Edhe dasma e dajës tim të madh, Lleshit, ka lënë gjurmë në kujtesën time. Ceremonitë martesore në ato kohë organizoheshin me shumë të ftuar. Thereshin bagëti të trasha e kur vinte nusja gjuhej me pushkë. Këndoheshin këngë majëkrahut e luhej kala dibrançe. Refreni i një kënge, “O sa bukur ka dalë nusja”, ishte gjithnjë si kolonë zanore e dasmës. Shumica e dasmorëve visheshin me kostume tradicionale. Kurse ditën e mbërritjes në shtëpinë e dhëndrit, nusja shpërndante dhurata për të ftuarit. Nga ky moment më kujtohet një histori e bukur:

“Nusja e dajës nusëronte në krahun e djathtë të derës së kasolleshtëpi. Kokën e mbante ulur, se kështu e donte zakoni. Në të djathtë të saj, një tjetër nuse, më e vjetër e fisit të dhëndrit, mbante thesin e qëndisur të dhuratave që do të shpërndante nusja për personin që i thirrej emri. Si kapërcyesi i kalit të nuses, një ritual i lashtë i zonës, unë e kisha marrë i pari dhuratën time, ishin një palë çorape. Me to në dorë, po qëndroja në fundin e oborrit me tim atë dhe dajën tim, Lleshin, dhëndër. Ato çorape nuk më pëlqyen, për më tepër që shikoja çorape edhe më të bukura që po u jepeshin të tjerëve. Të paktën kështu më dukej mua. Kur u shfaqën një palë çorape që ishin me ngjyrë jeshile dhe portokalli, u nisa rrufeshëm drejt nuses së re, e cila i mbante në duar. I lëshova çorapet e mia poshtë këmbëve të saj, rrëmbeva të tjerat nga dora dhe u zhduka në morinë e njerëzve që po festonin.” Kjo ngjarje bëri bujë atë ditë dhe për vite me radhë ma përmendnin historinë e çorapeve si veprim të një fëmije të paturpshëm e të llastuar te dajat e tij.

Kur lindi motra e dytë, unë isha pak më shumë se 5 vjeç. Prindërit e mi kishin dëshirë të lindte djalë. Atë ditë isha në shtëpi duke luajtur kukafshehthi me motrën e madhe dhe disa fëmijë nga shtëpia e Zogajve. Mbaj mend gjyshen që na urdhëroi të linim lojën e të dilnim jashtë oborrit. “Lojën vazhdojeni në kopsht!”, na urdhëroi gjyshja. Ndërkohë pamë që mbërriti në shtëpi një grua e moshuar nga fshati. Mara e Lleshit, kështu i thoshin. Ne nuk e dinim se përse kishte ardhur dhe as pse na kishin nxjerrë jashtë oborrit. Ajo na paskësh qenë “mamia” popullore e fshatit. Pas pak minutash dëgjuam një zë foshnje të qante. Në derë u shfaq gjyshja, e cila më tha se isha bërë me motër.

Manatia, sipas syrit tim, është fshat i bukur. Ai ndodhet shumë pranë qytetit të Lezhës, i vendosur rrëzë malit e shtrihet në fushë në formë gjysmëharku. Kjo vendosje gjeografike e mbron edhe nga erërat që Lezha i ka të vazhdueshme. Përroi Hut, që zbret nga Molungu, e ndan mes për mes fshatin, vijon nëpër fushë për t’i shkarkuar ujërat e tij në lumin Drin. Ndonjëherë në dimër, ai bëhet i rrezikshëm me prurjet e tij të befasishme. Thuhet se të parët tanë për këtë arsye ia vendosën emrin Hut, pra i hutuar, që nuk di se nga shkon. Shtëpitë janë të vendosura në të dyja anët e rrugës, dikur rruga nacionale Tiranë-Lezhë. Përgjithësisht fshati kishte kulla dykatëshe prej guri, por sot janë zëvendësuar me

shtëpi të reja e arkitekturë më moderne. Banorët janë autoktonë dhe me origjinë të gjithë mirditorë.

Para bonifikimeve që bëri qeveria në vitet '60, vendi që i mbuluar nga pyjet, që të mahnitnin me lartësinë dhe hijeshinë e tyre. Ishin pyje shekullore. Babai më tregonte se në vegjëlinë e tij, bagëtitë futeshin në mëngjes në ato kullota dhe ktheheshin vetë në darkë. Askush nuk i shihte gjatë gjithë ditës nga e ashtuquajtura “xhungla e madhe e pyjeve të pafundme”. Lagunat dhe kënetat e ndanin fshatin në pjesën perëndimore me Ishullin e Lezhës. Nga ballkoni i katit të dytë të shtëpisë sime arrija të vrojtoja diellin kur “mbytej” në det çdo darkë. Patat, rosat, pulëbardhat e zogjtë shtegtarë qenë të shumtë deri në rininë time. Në fshat, gjithashtu, rrëfehej edhe një legjendë: “Thuhej se njëri prej banorëve të tij kishte qenë dragua. Një ditë të nxehtë vere kishte mbytur kuçedrën me zgjedhën e qeve kur ato po pinin ujët e burimit të Gurrë Keqes.”. Banorët e Manatisë kanë pasur gjithnjë humor, ndoshta më të dallueshëm nga fshatrat përbri. Edhe një fjalë e urtë që ka qarkulluar gjithnjë, thotë: “Më mirë është të jesh në mort në Manati, se në dasmë në Tresh.”. (Treshi është fshati përbri Manatisë.) Kjo për vetë notat e humorit që me mjeshtri dinin t’i bënin edhe në një ceremoni mortore. Ka pasur plot burra të mençur nga fshati ynë që me thëniet e tyre kanë mbushur një pjesë të madhe të tri volumeve të mbledhura nga shkrintari Kujtim Dashi.

Stina e verës në fshat vinte gjithnjë e bukur. Gjinkallat të shoqëronin kudo me atë muzikalitetin e zërit të tyre të pandërprerë. Ato më së shumti i gjeje në majat e kumbullave dhe të ullinjve. Mua më pëlqenin shumë dhe shpesh ngjitesha për ta kapur ndonjërin prej tyre. Ndërmjet shtëpisë sime dhe të bashkëmoshatarit tim Preç Zogaj ishte një kanal që ndante dy kopshtijet tona, përshtuar me ujin e Gurrë Keqes, që nuk shteronte as në verën më të nxehtë. Bimësia e ujit bashkë me hijet e pemëve krijonte një mjedis për gjallesa të shumëllojta. Ngjante si një bimësi e vendeve tropikale. Shpeshherë shihja një zog të veçantë që fluturonte ngjitur me ujin, kishte sqep të gjatë, kurrizin në blu kobalt dhe flatrat ngjyrë portokalli. Ishte një zog shumë i bukur, por edhe shumë i rrallë, për vite të tëra ishte banor i këtyre rrethinave. Në këtë kanal të vogël kishte pilivesa e flutura të shumëllojshme, por edhe xixëllonjat përreth shtëpisë ishin pjesë e kureshtjes sime feminare. Kur shkoja te shtëpia e Preçit, gjithmonë te kapërcyelli “i vogël” i kopshtit të tij, përballësia

me një zhapik të madh me ngjyrë jeshile në të verdhë, a thua se ai ishte roja i kapërcyellit. Tani në kohë kaq të vonë, i mbetur gjithnjë në kujtesën time, më rikujton më shumë një dinozaur me përmasa të zvogëluara të parë nëpër filma. Preçi kishte edhe një qen të madh dhe të fortë me emrin Laca, që unë e kisha shumë frikë. Me siguri kishte lindur përpara nesh. Kur isha rreth moshës 10 vjeç qeni nuk shihte më, ishte verbuar. Kjo ma lehtësonte vajtjen te shtëpia e tij, megjithatë ndieja gjithnjë një mungesë sigurie kur përballesha me të. Me motrën time të madhe, Lizën, dhe së bashku me fëmijët e shumtë të shtëpisë të Zogajve, që ishin moshatarë me ne, kalonim orë të tëra mes lojërave të atëhershme, si kukafshehtas, rrasa-vijë, cingla etj.

Isha ende fëmijë kur pashë për herë të parë Panajot Panon dhe Lin Shllakun në një ndeshje futbollit në Lezhë. Kureshtja ime për të parë Panajot Panon bëri që dhe im atë të vinte në stadium. Atë ditë binte një shi i rrëmbyeshëm, që nuk pushoi gjatë gjithë ndeshjes. Rrëshqitjet e Panos në baltën e asaj ndeshjeje më kanë mbetur në mendje. Ndeshjen Shqipëri-Gjermani në vitin 1966 unë bashkë me shumë të rritur e kemi ndjekur në katin e parë të shtëpisë sime, me radion tonë “Orion”, në transmetimin e Anton Mazrekut dhe Ismet Bellovës. Rrallëherë shkonim edhe në qytet për të parë filma. Asokohe, aktorët tanë të preferuar ishin: Stive Rives, Jean Marais, Sofia Loren, Gerard Philippe, Norman Wisdom (Pitkin), Fernandeli etj.

Kur vinte dimri bënim gati armët tona të gjuetisë së zogjve, domethënë “llastiqet”. Megjithëse ato nuk na lejoheshin nga mësuesit, ne i mbanim pothuajse të gjithë. Kohën e lirë pas mësimeve e kalonim në gjueti. Gjuajtja me llastiqe ishte argëtimi më i madh që mund të na ndodhte. Edhe në dimër kishte zogj të shumtë. Mbresat dhe përjetimet e asaj kohe i kam ende në kujtesë. Një ditë të shtunë, bashkë me shokun tim Gjergj Kthellën, u ndodhëm para një të papriture të madhe. Kishim shkuar të gjuanim mëllenja tek Ura e Grykës. Vendi ishte i mbushur plot me plepa të mëdhenj, ferra dhe shkurre. Gjethet e plepit, të rëna në vjeshtë, formonin një shtresë të pafundme ngjyrë okër dhe mjaft të përshtatshme për mëllenjat, që kërkonin molusqet e fshehura poshtë gjetheve në tokën e nxehtë. Pikërisht në atë vend shkonin për të gjuajtur edhe fëmijë të tjerë. “Shokët tanë”, menduam, sapo pamë dy siluetat që dalloheshin nga larg. Por ishim gabuar. Kur u afruam, pamë se ishin

dy mësuesit tanë të rinj, që kishin dalë për të gjuajtur me llastiqe. Nuk i kishin mbushur ende njëzet vitet, ishin të rinj. Njëri ishte Ruzhdiu nga Kosova dhe tjetri Bexheti nga Mushqetaja e Tiranës. Me sa duket po argëtoheshin në gjueti. Bashkë me Gjergjin i përshëndetëm për së largu dhe me humor iu thamë: “Mësues Ruzhdiu dhe Bexheti, a keni vra gjë sot?”. Të dy mësuesit shtangën kur na panë. Bënë sikur nuk kishte ndodhur asgjë dhe na e bënë me dorë të afroheshim tek ata. “Hë, - na u drejtuan njëherazi të dy, - po gjuani me llastiqe?” “Po”, u përgjigjëm njëzëri. “Na ka thënë mësues Marku të vrasim ndonjë mëllenjë apo zog tjetër të madh, sepse dëshiron ta balsamosë për kabinetin e ri të zoologjisë.” Në fakt, kjo që po thoshim ishte e vërtetë. Një e vërtetë që nuk dihej se kur do ta kishte fundin, sepse gjithnjë e përdornim për t’u justifikuar kur na kapnin me llastiqe. “Kujt ia thoni ju këtë?”, na u drejtua mësues Ruzhdiu. Na bëri me shenjë të afroheshim edhe më shumë deri ku të kishte mundësi të na kapte. “Ashtu, ëëëë... ti do të vrasësh mëllenjë?”, më tha mua me një ton ironik. “Pale po i duhet edhe mësues Markut?” Emrin e Markut e stërzgjati me një të folur skenike. “Ta bëj unë tani mëllenjën ty!” Më bëri edhe një tërheqje të flokëve në rrëzë të veshit, në atë vend ku dhemb më shumë, duke e shoqëruar me një shpullë të nxehtë. Edhe Gjergji pati fatin tim. Të dyve na i morën llastiqet. Të mërzitur dhe “të çarmatosur” u kthyem në shtëpi. Por kujtimi i asaj dite nuk u shlye për shumë kohë. Kishim parë mësuesit tanë të gjuanin me llastiqe, çka për atë kohë ishte e pabesueshme nëse do të na e kishte thënë kush tjetër. Vite më vonë, ndoshta rreth të dyzetave, kam kuptuar se sa i padrejtë isha treguar. Më vonë, shpendët dhe kafshët u bënë pjesa e ndjeshme e imja për t’i ruajtur, dashur e trajtuar me më shumë dashuri.

Është e natyrshme që fëmijëve u pëlqejnë lojërat në përgjithësi. Kur ishim rreth klasës së tretë fillore, vëllai më i madh i një shokut tonë u bë trajneri ynë i gjimnastikës. Ky ishte Edmond Dushi me prindër nga Shkodra, por që punonin prej 20 vjetësh si mësues në Manati. Ose më mirë, Mondit ishte djali i dytë i mësuese Gjyljanës, e cila më kishte ndihmuar të regjistrohesha në klasën e parë fillore. Ai ishte 4 vjet më i madh se ne dhe i pëlqente gjimnastika. Edmondi na mësoi shumë ushtrime akrobatike. Ecnim në vertikale me duar me aq lehtësi, sikur të ishim duke ecur në këmbë. Si fushë stërvitjeje kishim oborrin

e shkollës. Dhe ishim disa fëmijë që bënë një gjë të tillë pa as më të voglin problem.

Unë, gjithnjë nga klasa e tretë fillore e deri në klasën e tetë, kam punuar gjatë dy muajve të verës për të siguruar të ardhura me të cilat do të blija rrobat e shkollës. Por ishte shumë e vështirë. Duheshin dy javë punë për të blerë vetëm një palë këpucë, formën dhe çmimin e tyre e mbaj mend edhe sot. Kushtonin 720 lekë dhe ne fëmijët i kishim vënë emrin “këpucë me tegel”. Bashkë me motrën time më të madhe, Lizën, kemi punuar në ngjitjen e vargjeve të duhanit. Ngriheshim herët pa zbardhur drita e mëngjesit, sepse kështu e kërkonte ky proces pune dhe vazhdonim deri në pasditen e vonë. Ishte punë e rëndë, por kjo ishte mundësia jonë e vetme. Ekonomia e familjes sonë nuk ishte e mirë. Ne ishim fëmijë që merrnim pjesë në hallet që kalonin familjet tona e që në atë kohë ishin të shumta. Kjo na bëri të ishim fëmijë të fortë, por përsëri e them me bindje se fëmijëria jonë megjithëse ishte e vështirë, ishte e bukur.

KLASA E PARË “DHURATË” NGA NËNA

Isha pak më shumë se 6 vjeç kur hyri shtatori i vitit 1964 dhe shokët e mi të fëmijërisë, Preç Zogaj dhe Gjergj Kthella do të hynin në klasë të parë. Sigurisht, që edhe unë e kisha menduar se do të isha në të njëjtën klasë me dy shokët e mi. Ne ishim pothuajse në të njëjtën një moshë.

Shtëpia ime ishte shumë afër me shkollën. Një hap larg oborrit të saj. Babai kishte miqësi me drejtorin e shkollës Ahmet Reçi. Ata kishin biseduar dhe kishin arritur një marrëveshje që unë të vazhdoja klasën e parë, por i paregjistruar si nxënës i rregullt, për arsye të moshës. Pra do të ndiqja orët e mësimin, por edhe mund të largohesha kur të doja. Marrëveshjen e fshehtë të babait me drejtorin nuk e dija, por e mësova më vonë. Dija vetëm se kisha hyrë në klasë të parë njëherësh me shokët e mi. Mësuesja jonë e klasës së parë ishte Fahrije Hafizi nga Shkodra. Ajo ishte një vajzë e re, ezmere, e veshur me të zeza, me shtatin e shkurtër dhe e dashur me ne fëmijët. Mund të them se ajo e dinte historinë time të pranimit në klasë të parë, por asnjëherë nuk e dha veten që unë të kuptoja diferencën me fëmijët e tjerë në kërkesën e llogarisë për mësimin. Kur mësuesja bënte apelin në klasë, emri im nuk thirrej asnjëherë, por si i vogël që isha, nuk bëja zë dhe as nuk dija çfarë të thosha. Mësuese Fahrija më mbante afër, ndoshta se nuk donte të lëndohesha. Rreth dy muaj më vonë, në pushimin e madh, mësuese Gjyljana Dushi po bisedonte me drejtor Ahmet Reçin, nën hijen e selvisë së madhe, përpara hyrjes së shkollës. Nuk isha shumë larg tyre, kur ajo ma bëri me dorë të afrohesha. Mësuese Gjyljana më mori pranë vetes dhe në prezencën time, me një ton lutës, fjalët e saj i kujtoj dhe sot, iu drejtua drejtor Ahmetit: “Ta regjistrojmë edhe Pashkun në klasë të parë,

se edhe ky është në nivelin e nxënësve të tjerë, shkollën e ka afër dhe është djali i Gjokës, që ti e ke shok.”. Mua më çuditën fjalët e saj, aq sa nuk po kuptoja asgjë. Ai nuk foli, u mendua pak, pastaj shtoi: “Mirë, moj Gjyljanë, mirë, le të bëhet siç thua ti. Thuaji mësuese Fahrijes ta regjistrojë edhe mecin e Gjok Përvathit.”. Pastaj më kapi për veshi (si gjest intimiteti), ishte një zakon i tij që ne ia dinim, ma tërhoqi pak dhe m’u drejtua me fjalët: “Ik e thuaji Gjokës se Ahmet Reçin e ke sot për drekë!”.

Unë përsëri nuk kuptova çfarë kishte ndodhur në ato çaste me mua, por të nesërmen vura re një ndryshim. Në apelin e mëngjesit dëgjova edhe emrin tim, por me një ndryshim nga të tjerët në renditje: emri im në regjistër, nuk vinte në radhë siç e donte rregulli, te P-ja, por ishte në fundin e emrave të tjerë.

Kohë më vonë mora vesh të vërtetën. Unë isha pranuar në klasë të parë si dëgjues, pasi kisha ngulmuar për të qenë në një klasë me dy shokët e mi të lagjes sime. Në atë periudhë pranoheshe në shkollë vetëm kur i kishe mbushur 7 vjeç. Pra klasën e parë e kam “dhuratë” nga nëna, që ia kërkoi këtë nder mësuese Gjyljanës për të folur me drejtorin, që unë të kthehesha në nxënës të rregullt.

E kujtoj atë periudhë, por më duhet të them se nuk kam shkëlqyer në klasë të parë, isha thjesht një nxënës mesatar në mësim. Kam pasur rritje në klasat e mëvonshme, por kujtimin më të bukur mbaj mend në klasën e tretë fillore, kur mësuese Sadete Dibra më caktoi që të bëja fotografi për Këndin e të dalluarve të klasës.

PORTRETI IM... PREJ NJË PIKTORI TË PANJOHUR

Rreth mesit të paradites, dikush trokiti në derën e klasës sime. Një nxënës i klasave më të rritura, iu drejtua mësuese Fahrijes duke i thënë se drejtor Ahmeti kishte urdhëruar që unë duhej të shkoja në shtëpi. Mësuesja më bëri shenjë të dilja. “Merre edhe çantën, - më tha, - se edhe një orë mësimi kemi e do të shpërndahemi të gjithë.” Ashtu bëra, por nuk e dija pse isha thirrur. Për të shkuar sa më shpejt dola nga dera e pasme e shkollës, që ishte përballë me shtëpinë time. Në oborr gjeta gjyshen. Ajo më tha të ngjitesha në katin e dytë, se aty më priste im atë, por asgjë më tepër nuk më sqaroi. Ngjita shkallët me të shpejtë. Turrin e ndala në hyrje të dhomës. U stepa menjëherë, sepse babai nuk ishte vetëm. Bashkë me të, në mesin e dhomës së miqve, i ulur në karrige ishte një mesoburrë. Të dy kishin përpara nga një gotë raki. Njeriu që unë shihja për herë të parë më thirri të shkoja pranë tij. U tregua shumë i afërt me mua, me sa duket për të më hequr ndrojtjen që e shfaqta sapo pashë njeriun e panjohur. Më pyeti për shkollën, më rregulloi pak flokët dhe jakën e këmishës dhe më tha të ulesha në një vend afër dritares, aty ku kishte më shumë dritë. Në dorë mbante diçka të zezë. Vite më vonë mësova se ajo e kishte emrin “dosje” dhe përdorej prej piktorëve. “I panjohuri” më shpjegoi butësisht dhe kuptueshëm gjithë qëllimin e tij.

- Do të të bëj një portret, - më tha.

- Portret! - ia ktheva me habi. As që e dija çfarë do të thoshte fjala portret, isha veçse shtatë vjeç.

- Po, po, portretin tënd unë do ta bëj këtu në letër, por ti do të rrish si të them unë dhe të mos lëvizësh. Nuk do të lodhesh, sepse do ta realizoj shpejt. Ja, ke për ta parë vetë sa gjë e lehtë është!

Për të më bindur të pozoja si model, ndërhyri babai duke më thënë se do ta vendoste portretin në kornizë dhe do ta mbante këtu në dhomën e pritjes. U binda shpejt dhe qëndrova ashtu për një kohë të gjatë. Ndoshta s'ka qenë kohë e gjatë, por mua kështu m'u duk. Herë pas here më kapte një e qeshur, nuk e di as vetë pse. Kur piktori e mbaroi punën që kishte nisur, pashë veten time të hedhur në letër. U ndjeva i befasuar. Më kishte bërë bukur. Isha tamam unë, me flokët mënjanë, me një këmishë me dy xhepa, që asokohe ngjante si këmishë ushtarake. Por për një gjë çuditesha. Piktori më kishte bërë sikur fërshëllezja, e unë me padjallëzinë e një fëmijë 7-vjeçar i them se unë nuk isha duke fërshëllyer.

- Ti qeshje herë pas here, - më tha ai. - E unë, buzëqeshjen tënde kam dashur të bëj.”

Ai realizoi edhe portretin e tim ati dhe të xhaxhait tim, Zefit, që asokohe nuk jetonte. Atë e bëri nga një foto e tij. Të tria portretet babai i vendosi në korniza dhe i ekspozoi në murin e dhomës së miqve.

Në ditët që kalonin, por edhe në vitet që pasuan, unë përpiquesha t'i ripunoja portretet, e veçanërisht atë të babait. Sot, kur kthehem prapa në kohë dhe kujtoj të kaluarën time, mendoj se sa shtysë e madhe për t'u marrë me profesionin që kam sot ka qenë pikërisht ajo ditë që unë pozova për portretin tim para atij piktori në shtëpinë time. Kam menduar gjithnjë për atë njeri, isha dhe jam i sigurt se ai ishte një piktor profesionist. Po pse kishte ardhur në Lezhë? Edhe këtu e kam një përgjigje. Duket se lëvizjet që diktoheshin nga Partia për artistët, që të njihnin jetën poshtë në bazë, e kishte bërë edhe këtë piktor që një ditë të ishte në Manati të Lezhës e unë të kisha fatin të gjendesha para tij. Për fat të keq, portretin nuk e kam sot. Ai, pas rreth 10 vjetësh, u dëmtua nga një bojaxhi i pakujdesshëm kur leu shtëpinë tonë. Bojaxhiu Ndoc, i ardhur nga Shkodra, me një nam të rremë si supermjeshtër, i kishte hequr portretet nga muri dhe i kishte vendosur sipër raftit të rrobave në qoshe të dhomës së pritjes. Gëlqerja e tavanit kishte pikuar përsipër. Lëngu i gëlqeres i mbledhur brenda kornizave kishte depërtuar deri te letra e vizatimit duke i dëmtuar të tria portretet. Unë u mërzhita shumë e për shumë kohë e kam vuajtur dëmtimin e tyre.

Realizimi i portretit mbetet dita e injektimit të ëndrrës. Ai portret më vuri në një rrugë të re të jetës sime. Gjithmonë ia kam përmendur tim ati gjestin e madh të tij, duke sjellë në shtëpi piktorin për realizimin e portretit tim.

FATKEQËSIA QË I NDODHI NËNËS

Në fillim të shkurtit të vitit 1964, nëna pësoi një aksident të rëndë në punë. Punonte në blegtori në rritjen e viçave. Një ditë e ftohtë dimri rezultoi fatale për shëndetin e saj. Të ulur rreth zjarrit në pushimin e drekës bashkë me gratë e tjera, një dobësi dhe gjendje të fikëti prej shtatzënisë, bëri që ajo të binte përmbys një ene me ujë të valuar. Ndhimën e parë ia dhanë në spitalin e Lezhës, por gjendja e rëndë e saj kërkonte shërbim më të specializuar dhe menjëherë e nisën për në spitalin e Shkodrës. Lajmi u përhap gjithandej. Unë isha i vogël, në klasë të parë. Atë ditë mësuese Gjyljana erdhi në klasën tonë, i tha diçka nën zë mësuese Fahries, u drejtua nga unë dhe ma bëri me dorë të shkoja pranë saj. Më mori pranë vetes, më fërkoji kokën në mënyrë ledhatuese dhe më tha: “Shko nga shtëpia më herët sot. Merre edhe çantën e librave, sepse i mora leje për ty mësuese Fahries.”. Dola me nxitim, as vetë nuk e di se pse. Sapo u afrova pranë shtëpisë, sytë më zunë disa njerëz që po qëndronin në oborr, të tjerë që hynin dhe dilnin pa ndërprerë. Një heshtje e madhe mbretëronte gjithandej. Thua se këta njerëz nuk kishin gojë për të folur. Kishte vetëm pëshpëritje dhe fytyra të vrerosura. Babai nuk ishte në shtëpi. Pak më vonë, nëna e Gjergjit na tregoi mua dhe motrës sime më të madhe, Lizës, se nëna ishte pak e sëmurë, prandaj dhe e kishin nisur për në spital. Lajme të tjera nuk po merrnim. Edhe pse të vegjël, arrinim të kapnim edhe biseda që na linin të kuptonim se nëna ishte shumë rëndë. Nënë e kishin dërguar urgjent për në spitalin e Shkodrës dhe kur babai u kthye pas dy ditësh nga Shkodra, na qetësoi duke na thënë se ishte më mirë dhe së shpejti do të dilte nga spitali. Në shtëpi ndihej mungesa dhe dashuria e saj, edhe pse

mundohej me gjithë forcat e saj të na e plotësonte gjyshja jonë Marë. Na mbante afër, por edhe nën një mbikëqyrje të rreptë. Kishte frikë mos na ndodhte ndonjë e keqe, sepse për gjyshen ne ishim amaneti i nënës sonë. Edhe një detaj tjetër shumë i rëndësishëm që nuk mund ta lë pa përmendur: Në atë kohë, kur nëna u aksidentua, qe shtatzënë dhe vetëm pas pak ditësh lindi vëllai im, Gjovalini. Sapo erdhi në jetë vëllai, u prek nga sëmundja e verdhëzës. Edhe gjendja e tij qe e rëndë dhe ndoshta u konsiderua e pashpresë. Përveç hallit të nënës së sëmurë, babait tani iu shtua edhe sëmundja e vëllait tim të vogël. Fati i tij do të vendosej nga blerja e tri gjilpërave të kushtueshme që nuk ishin në shitje të lirë, por i kishte një mjek, i cili i kishte siguruar nga jashtë vendit për një të afërmin e tij. Kur ia treguan këtë lajm tim ati, ai, megjithëse ishte “i shkundur” financiarisht, nuk kishte hezitur për t’i marrë ato tri gjilpëra të kushtueshme sa tri rroga mujore të tij, por që kishin vendosur edhe fatin e mbijetesës së tim vëllai.

Nga koha e aksidentit kishin kaluar rreth 2-3 muaj, por nëna vazhdonte të ishte përsëri në spital. Nuk kishte mbetur njeri në Manati që nuk kishte vajtur për ta vizituar. Për t’i hequr mërzinë nënës sime, por edhe mua, pas disa kohëve babai më mori me vete në Shkodër. Ajo ishte e shtruar në “spitalin e madh”. Këtë emër spitalit ia kishin vënë vetë njerëzit. Ndoshta edhe prej madhësisë së tij. Ajo ishte një ndërtesë e vjetër, por e bukur, veshur me tulla të kuqe, e ndërtuar që në kohën e Italisë. Pasi ecëm përgjatë korridorit të katit të dytë, një korridor i gjatë dhe i lartë, babai mori drejtimin në të djathtë, në një dhomë me derë të hapur. Në krevatin në krye të dhomës ishte një e shtruar. Aty për aty mendova e shpresova shumë të mos ishte nëna ime ajo me kokë të lidhur. Por jo. Nuk ndodhi ashtu si mendoja. Ajo ishte pikërisht nëna ime. Me zor e njoha nga dëmtimi i madh që kishte pësuar fytyra e saj nga djegia e thellë. Ishte krejtësisht e transformuar. Më thirri afër vetes për të më prekur me dorë. U afrova pranë saj, por menjëherë m’u zu fryma nga era e ilaçeve dhe dhimbja e madhe që ndjeva për të. Ndjeva një dobësi dhe gati po më binte të fikët. Sapo e kuptuan këtë ndjesi, më nxorën në korridorin e madh për të më dhënë ndihmën e shpejtë. Më vonë u qetësova. Qëndrova pranë saj për pak kohë derisa u nisëm për t’u kthyer në Lezhë.

Babai im po jetonte me një gjendje shpirtërore tejet të ngarkuar. Një hall i madh e kishte zënë. Në shtëpi na kishte ne, tre fëmijët, ndërsa në

Shkodër kishte gruan e sëmurë me një djalë të vogël në çerdhen e spitalit. Ai gjithnjë përpiqej të na e zbuste sadopak dhimbjen që ne ndienim për nënën tonë të dashur. Mendohej të na e plotësonte mungesën e saj me shërbimet ndaj nesh. Shpesh, kur kthehej nga Shkodra, na binte dhurata ose gjëra për të ngrënë, kryesisht gurabija. Por unë kisha edhe kërkesat e mia, të cilat ia bëja sa herë nisej për në Shkodër. Ishin modeste dhe fëmimore: top llastiku dhe lapsa ngjyrash. Me gjithë vështirësitë që kalonte im atë, për shkak të shpenzimeve të shumta që bënte për shërimin e nënës, ai asnjëherë nuk i harronte porositë e mia. Unë kisha top dhe lapsa ngjyrash. Për lapsat ruaj edhe një kujtim. Kisha një shok banke që m'i merrte vjedhurazi një e nga një. Një ditë e dallova dhe e padita te mësuese Fahrija. Edhe kjo ka ndodhur kur isha në klasën e parë fillore. Përsëri në arsyetimin tim të sotëm nga larg, mendoj se kërkesa ime për lapsa ngjyrash, ishte shenja e parë që tregonte se doja të vizatoja. Ishte gjurma që piktori i panjohur pak muaj më parë kishte lënë në ndërgjegjen time.

Gjendja shëndetësore e nënës sime të mirë vazhdonte të ishte e rëndë. Fytyra e saj, e një ish-gruaje të bukur, nuk ishte dhe as nuk mund të bëhej më e tillë. Asokohe specialistët e djegieve mungonin. Ajo mbeti rreth dy vjet vajtje-ardhje në spitalin e Shkodrës e më vonë në atë të Tiranës. Gjithë jetën e vuajti nëna ime aksidentin e asaj dite dimri kur iu dogj fytyra në ujin e valuar teksa ishte në punë! Por gjendjen e saj e vuajtëm edhe ne. Unë e dija se si kishte qenë dikur nëna ime, ia mbaja mend mirë portretin e hijshëm. Motra pas meje ishte shëmbëllimi i nënës. Me gjithë shëndetin e dëmtuar të saj, ajo gjithnjë sakrifikoi për rritjen tonë. Sa shumë vuajti ajo, por kurrë nuk u ankua!

NJË “PADREJTËSI” E VOGËL

Në klasën e dytë fillore patëm një mësues të ri nga Lezha, të cilin pak muaj më vonë e zëvendësoi motra e tij, Sadete Dibra. Mësues Shabani ishte i ri, çapkën, kishte flokë me onde që i ndrisnin nga lyerja me ndonjë solucion. Shpeshherë mësimin e bënte argëtues duke e shoqëruar edhe me histori të këndshme për moshën tonë fëmimore. Mua më njihte si djalin e Gjokës dhe shpesh më pyeste për tim atë. Një ditë, më erdhi radha të ngrihesha në mësim. Kur unë u bëra gati të shkruaja në dërrasën e zezë, mësues Shabani m’u drejtua:

- Pashk, ju po martoni Gjergjin, kushëririn tuaj. Gjoka duhet të këtë blerë shumë gjëra për martesën e nipit të vet. Prandaj, edhe problema që do të zgjidhësh ka të bëjë me dasmën e Gjergjit.

Unë u habita se ç’lidhje kishte dasma e kushëririt tim me pyetjen që do të më bënte ai. Edhe fëmijët e tjerë u bënë kureshtarë. Mësues Shabani ishte edhe aktor me estradën e Lezhës dhe të gjithë po mendonim ndonjë shaka të radhës që ai i bënte shpesh me ne nxënësit në mësim. Por jo, pyetja ishte formuluar vërtet në lidhje me dasmën tonë që sapo kishte filluar.

- Sa kg arra dhe sa kg llokume ka blerë Gjoka për dasmën e nipit? Sa është çmimi për kg dhe sa lekë kushtojnë të gjitha?

Mbeta i ngrirë në dërrasë. Ne nuk i kishim zakonet si të qytetit për të bërë shpenzime për qerasje. Ne, bile, asnjëherë nuk përdornim llokume dhe arra në dasmat tona në fshat. Te ne pritëshin bagëti dhe mishi shkonte deri në “gju”. Unë vazhdoja të rrija me shkumës në dorë dhe as që po më vinte ndonjë ide për zgjidhjen e problemit.

- Hë, bëje! - më tha. - Nuk është e vështirë. Gjoka do të jetë përgatitur për dasmën e nipit!

Por unë prapë isha i bllokuar. Iu drejtova duke i thënë se babai nuk kishte blerë as arra dhe as llokume. Unë isha i vogël për të arsyetuar, se ne nuk e kishim zakon që në dasma të bënim qerasje të tilla si në qytet. Këtë e kuptoi edhe vetë mësuesi, i cili më ra shpatullave dhe më uli në vend.

Kur kishin kaluar katër muaj, mësues Shabani shkoi ushtar dhe e zëvendësoi e motra, Sadetja. Ajo ishte e re, e bukur dhe mësimin na e bënte tejet argëtues. Shkonim me dëshirë të madhe në shkollë. Por asnjëherë nuk e kuptova një “padrejtësi”, nëse mund ta quaj kështu, që ajo më bëri kur isha nga fundi i klasës së dytë. Ishim në orën e vizatimit. Kishim një temë që ka ekzistuar në planet mësimore edhe për shumë vite më vonë. E mbaj mend mirë, se edhe kur unë u bëra mësues, kjo temë ishte përsëri, e njëjtë siç kishte qenë kur isha nxënës në klasë të dytë: “Motive floreale me gjethe”. Isha në një bankë me Preçin, nxënësin më të mirë të klasës dhe shokun tim më të ngushtë. Pasi bëra vizatimin tim, bëra dhe të Preçit. Por kur mësuesja vuri notat, nuk e kuptova se, pse mua më vendosi notën 9 e Preçit 10. Mendova me vete: “Po unë i bëra të dyja vizatimet, pse të ndodhë kështu?”. Kur jam rritur, kam arsyetuar se mësuesja kishte ecur me opinion. Preçi, meqë ishte nxënësi më i mirë në mësim, edhe në vizatim duhej të merrte 10. Kjo “padrejtësi” më mbeti në kujtesë për shumë kohë. Prej saj, më vonë, munda të dalloj se unë asokohe vizatoja pak më mirë se bashkëmohatarët e mi.

U BËRA “PIKTOR” NË SPITALIN E SHKODRËS DUKE VIZATUAR LETRAT “SPATHI”

Në prillin e klasës së katërt përfundova në spital. U preka nga verdhëza. Në fakt, shenjat e para të kësaj sëmundjeje i ndjeva shumë ditë para se ajo të konstatohej. Kisha këputje e dhembje të gjunjëve. Ndihesha i lodhur. Iu isha ankuar edhe prindërve, por ata mendonin se këto dhimbje dhe lodhje vinin nga loja e shumtë që bëja me top gjithë ditën.

Një ditë gjatë drekës, nëna e pikasi zverdhjen e syve të mi. Thirri tim atë dhe menjëherë më dërguan për analiza në Lezhë.

- Është prekur nga verdhëza, - tha mjeku laborant, - prandaj duhet të shtrohet në spitalin infektiv të Shkodrës. Mirë është të shtrohet që sot, - përfundoi ai.

Po atë pasdite mbërritëm në Shkodër. Spitali ishte në pjesën veriore të qytetit, i rrethuar nga disa selvi të gjata. Dhoma e shtrimit ishte në katin e dytë nga pjesa jugore e spitalit. Njëherazi me mua u shtruan edhe tre fëmijë të tjerë. Njëri prej tyre ishte në moshë pak më të vogël se unë dhe vinte nga Puka. Ishte djali i drejtorit të sharrave të Pukës. E quanin Boris. Prindërit e tij ishin nga Korça. Borisi i vogël ishte nën kujdesin e madh të familjes së tij. Dukej që kishin mundësi të mira ekonomike që ta kryenin gjithë këtë kujdes për djalin e tyre. Bile, edhe nëna e tij, Sofika, erdhi të banonte në spital në një dhomë me të. Mua m'u desh të kaloja në një dhomë tjetër, pasi gjithë kujdesi i spitalit ishte kthyer në shërbim të Borisit të vogël. Në dhomën e re ku më vendosën, kishte fëmijë të moshës sime. Aty zura plot shokë. Ata ishin kryesisht nga Shkodra. Njëri quhej Fiqeret Digli, ndërsa fëmija

tjetër ishte një vajzë, Ervehe Bakalli. Fiqereti ishte një vit më i madh se unë. Ishte i shkathët dhe trupgjatë. Pëlqente të bënte shaka dhe të fliste për sportin, të cilin edhe unë e pëlqeja shumë që në atë moshë. Në dhomën e burrave bashkë me Fiqeretin dëgjuam përmes radios edhe ndeshjen “Vllaznia”-“Gençlerbirligi” i Ankarasë për kupën ballkanike e fituar nga “Vllaznia” me gol të Selami Danit në fundin e pjesës së parë. Ndonjëherë u merrnim të rriturve letrat “spathi”, por kjo nuk e zgjidhte hallin tonë. Një ditë, Fiqereti propozoi një zgjidhje:

- Të bëjmë letrat tona, - tha. - Për letra do të përdorim kartonin e paketave të duhanit “Diamant”.

Ishte djalë qyteti dhe dukej që ishte i shkathët dhe i sprovuar. Dhe ashtu bëmë. U organizuam të gjithë fëmijët për të gjetur paketa duhani “Diamant”. Faqja ballore prej kartoni të bardhë kishte në qendër të saj një deve që ecte në shkretëtirë. “Gjuetinë” e paketave e bëmë te dhoma e madhe e burrave. Ata tregoheshin bujarë në kërkesën tonë për t’i boshatisur paketat, qoftë kur ato ishin të mbushura plot me cigare. Së bashku me Fiqeretin dhe Ervehenë filluam punën për shkrimin e letrave. Për model morëm një palë letra “spathi” nga dhoma e të rriturve. Kur erdhëm te figurat “J”, “Q”, “K”, Fiqereti dhe Erveheja u dorëzuan. Pa e ditur as vetë nëse do t’i bëja apo jo, ato i mora përsipër unë. Dolën të mira. Edhe vetë unë u gëzova shumë për çfarë kisha bërë. Kur të rriturit na i panë, edhe atyre u pëlqyen shumë. Bile u bë në modë realizimi i letrave nën shembullin tonë me paketa “Diamant”. Megjithëse burra të rritur, edhe ata ndeshnin në një vështirësi. Vizatimi i “J”-së, “Q”-së, “K”-së nuk ishte i lehtë të realizohej prej tyre dhe filluan të kërkonin ndihmën time. Më merrnin në dhomën e tyre të madhe, më qerasnin dhe përpara më vinin 12 kartonë të bardhë për të vizatuar “J”-në, “Q”-në dhe “K”-në. Njëri nga të rriturit që ishte aty, më pyeti:

- Nga je ti, mor djalë?

- Nga Lezha, - i thashë.

- Ouuu! - tha. - Qenkemi patriotë. Unë jam mësues në qytet dhe e kam emrin Berhan Golemi. - Më mori pranë dhe me zë të lartë, që ta dëgjonin edhe të tjerët, tha: - Atëherë, ty patriotin tim, që vizatuake kaq bukur, do të të bëjmë piktor.

Ishte hera e parë në jetën time që dëgjoja fjalën “piktor”. Mua më pëlqente të vizatoja, por fjala “piktor” nuk kishte hyrë akoma në fjalorin tim të asaj moshe. U llastova pranë tij e më pëlqeu shumë ajo që mësues

Berhani më tha. Ato ditë bëmë disa palë letra të tilla, e unë “piktori”, tani i bëja më me siguri vizatimet e “J”-së, “Q”-së dhe “K”-së.

Qëndrimi im në spital zgjati 7 javë. Ishte kohë pranvere. Sapo mbërrita në shtëpi të gjithë shokët e klasës erdhën për të më uruar shërimin nga sëmundja. Kishin kaluar 7 javë, por mua dhe atyre na dukej se kishte qenë një kohë shumë më e gjatë. Shokët më treguan për ndeshjet e futbollit që kishin zhvilluar me klasat e fshatrave fqinje dhe që i kishin fituar. Por edhe unë doja t’iu tregoja se çfarë kisha mësuar në Shkodër dhe, aty për aty, iu ndërtova një balonë prej letre. Shokëve iu pëlqeu shumë, sa që të nesërmen e në ditët në vazhdim balonat i shikoje të fluturonin mbi kokat e njëri-tjetrit si në orën e mësimin, por edhe jashtë në oborrin e shkollës.

Pas disa ditësh, në Manati erdhi skuadra e qytetit të Lezhës për të luajtur një ndeshje futbollit me ekipin e shkollës sonë. Mësuesi shoqërues i tyre që Berhan Golemi, i njohuri im i spitalit në Shkodër. Nuk hezitova dhe shkova menjëherë të përshëndetem me të.

- Oooo, - ia bëri ai, - miku im i spitalit! - Më afroji nga vetja dhe iu drejtua disa mësuesve të Lezhës dhe të Manatisë që kishte aty afër: - Ky djali këtu vizaton shumë bukur. Mendoj se duhet ta bëjmë inxhinier.

Të tjerët miratuan, ndërsa unë ula kokën i mërzhitur në shenjë mosmiratimi. Këtë gjest, me sa duket e dalloj edhe vetë mësues Berhani. Unë nuk e dija se çfarë do të thoshte “inxhinier”, pasi mendja më kishte mbetur te fjala që më kishte thënë në Shkodër: “Do të të bëjmë piktor!”.

- Çfarë ke, - më tha, - nuk të pëlqen?

- Jo, i thashë. - Mua në Shkodër më ke thënë se “do të të bëjmë piktor”.

Plasi një qeshur e madhe nga të gjithë mësuesit e pranishëm.

- Mirë, mirë, - tha përsëri mësues Berhani, - piktor do të bëjmë.

E kishte kuptuar edhe ai ku “flinte” dëshira ime fëmijërore. Nga ajo ditë e mbrapa unë fillova të mendoj vetëm për këtë fjalë të bukur “piktor”, që ishte ngjizur kur kisha pozuar para piktorit për portretin tim në klasën e parë dhe u konsolidua në spitalin e Shkodrës në një moment të vështirë të jetës sime.

Ndërsa shokun e dhomës time, Fiqeretin, me të cilin punuam letrat e lojës në vitin 1968, e takova mbas 48 viteve në Shkodër. E gjeta përmes *Facebook*-ut të djalit të tij. Ruante akoma temperamentin e fëmijërisë.

NXËNËS NË TETËVJEÇARE

Kur kaluam në klasën e pestë, lëndën e vizatimit do ta bënim me mësues të profilizuar. Ky ishte një gëzim i madh për mua. Asim Kraja nga Shkodra kishte ardhur në moshë të re në Manati. E donte shumë lëndën dhe qe shumë i dashur me ne nxënësit. Kishte shumë humor, të cilin e përcillte me nota profesionale edhe në estradën e qytetit tonë të Lezhës, si pjesëtari më i spikatur i saj. Po nga Shkodra kishim edhe mësues të tjerë. Më i shquari ndër ta, Nush Radovani, një shkencëtar i vërtetë, që studimet i pati mbaruar në Itali me medalje të artë. Thoshin se kishin rënë kambanat e “D’Uomo”-s në Firence kur ai kishte mbrojtur diplomën me rezultate të shkëlqyera. Por lufta e klasave nuk e lejonte të punonte si mësues në qytet. Ishte i prekur politikisht. Këtë shkencëtar dhe njeri të shkëlqyer, fëmijët e Manatisë patën fat ta kishin mësues për një dekadë. Hysni Skënderi ishte nga Tirana, na jepte lëndën e historisë dhe njëkohësisht ishte dhe futbollisti më i mirë dhe kapiteni i skuadrës së “Besëlidhjes”. Hedije Muça, erdhi vajzë e re në Manati, por dëshmoi më vonë se ishte një gjuhëtare e shkëlqyer. Kishim Hëna Gjikën, mësuese fizkulture, një beratase e martuar me një djalë lezhjan. Vetë Hëna ishte kampione e vendit në 7-garësh dhe e arsimuar në Bullgari. E them pa më të voglin dyshim se Manatia e viteve ’70 kishte mësuesit më të kualifikuar se vetë qyteti i Lezhës. Dhe kjo për të vetmin fakt se të gjithë këta mësues të shkëlqyer, në biografinë e tyre kishin një “shenjë” që regjimi i atëhershëm nuk i lejonte të punonin në qytet. Të punoje në Manati konsiderohej ngushëllim i madh për të gjithë këta mësues, pasi ky fshat ishte në aksin e rrugës nacionale Lezhë-Tiranë dhe vetëm 3 km larg qytetit. Pushteti e kishte pranuar në